



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 63

Tiranë – E premte, 4 prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 15/2025, datë 13.3.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar 7479
Dekret i Presidentit nr. 107, datë 2.4.2025	Për shpallje ligji..... 7484
Ligj nr. 17/2025, datë 13.3.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit për financimin e projektit “Sistemi i kamerave në administrimin e Policisë së Shtetit – <i>Smart City</i> ” 7484
Dekret i Presidentit nr. 102, datë 27.3.2025	Për shpallje ligji..... 7493
Ligj nr. 21/2025, datë 13.3.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar..... 7493
Dekret i Presidentit nr. 103, datë 1.4.2025	Për shpallje ligji..... 7497
Ligj nr. 22/2025, datë 13.3.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë” 7497
Dekret i Presidentit nr. 104, datë 1.4.2025	Për shpallje ligji..... 7499
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 11, datë 10.3.2025	Për eksportin e produkteve dhe nënprodukteve përfundimtare të bimës së <i>cannabis</i> -it për qëllime industriale..... 7499

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 304, datë 28.3.2025	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe grumbullimin e riprodhuesve të krapit.....	7504
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 305, datë 28.3.2025	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Shkodrës	7504
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 306, datë 28.3.2025	Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.....	7505



LIGJ
Nr. 15/2025

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
DUKATIT TË MADH TË
LUKSEMBURGUT PËR MBROJTJEN E
NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

Shpallur me dekretin nr. 107, datë 2.4.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH
TË LUKSEMBURGUT PËR MBROJTJEN E
NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut (në vijim të referuara si “Palët”),

duke qenë të ndërgjegjshëm se bashkëpunimi efektiv në çështjet politike, ekonomike, ushtarake, të sigurisë, shërbimeve të fshehta/inteligjencës dhe çdo fushe tjetër, mund të kërkojë shkëmbimin e Informacionit të Klasifikuar ndërmjet Palëve;

me dëshirën për të vendosur një sërë rregullash që rregullojnë mbrojtjen e ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar të gjeneruar ose të shkëmbyer gjatë bashkëpunimit ndërmjet Palëve,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivi dhe objekti

1. Objektivi i kësaj Marrëveshjeje është garantimi i mbrojtjes së ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar që gjenerohet ose shkëmbehet zakonisht ndërmjet Palëve.

2. Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për çdo aktivitet, kontratë ose marrëveshje që lidhet me Informacionin e Klasifikuar që do të zhvillohet ose lidhet ndërmjet Palëve në të ardhmen.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen edhe për Informacionin e Klasifikuar tashmë të gjeneruar ose të shkëmbyer në procesin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje

1. **“Informacion i Klasifikuar”** nënkupton çdo informacion, pavarësisht nga forma, që transmetohet ose gjenerohet ndërmjet Palëve, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të një Pale, i cili kërkon mbrojtjen ndaj zbulimit të paautorizuar, përfuturit të parregullt ose humbjes dhe për të cilin është zbatuar një klasifikim sigurie;

2. **“Nevoja për informim”** nënkupton nevojën për të pasur akses në Informacionin e Klasifikuar në objektin e detyrave të dhëna zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre specifike;

3. **“Shkelje e sigurisë”** nënkupton një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, rezultati i të cilit mund të çojë në zbulim, humbje, asgjësim, përfutim të parregullt ose një lloj tjetër cenimi të Informacionit të Klasifikuar.



4. **“Palë e Originës”** nënkupton Palën, duke përfshirë çdo subjekt që jep Informacion të Klasifikuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme;

5. **“Palë Marrëse”** nënkupton Palën, duke përfshirë çdo subjekt të cilit i jepet Informacioni i Klasifikuar i Palës së Originës;

6. **“Palë e tretë”** nënkupton një organizatë shtetërore ose ndërkombëtare që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje;

7. **“Autoriteti Kombëtar i Sigurisë”** nënkupton autoritetin e brendshëm, i cili në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe për kontrollin e mbrojtjes së Informacionit të Klasifikuar të gjeneruar ose të shkëmbyer në pajtim me këtë Marrëveshjeje.

8. **“Kontraktues”** nënkupton një person fizik ose juridik që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

9. **“Nënkontraktues”** nënkupton një Kontraktues me të cilin hyn në nënkontraktim një Kontraktues kryesor.

10. **“Kontratë e Klasifikuar”** nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Kontraktuesve ose Nënkontraktuesve, e cila përmban ose ekzekutimi i së cilës përfshin gjenerimin ose shkëmbimin e Informacionit të Klasifikuar;

11. **“Leje Sigurie Personeli”** nënkupton përcaktimin nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë që konfirmon, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme që individi është i pranueshëm për të pasur akses tek Informacioni i Klasifikuar deri në një nivel të caktuar klasifikimi sigurie;

12. **“Leje Sigurie Struktura”** nënkupton përcaktimin nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë që konfirmon, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, që individi është i pranueshëm për të pasur akses në Informacionin e Klasifikuar deri në një nivel të caktuar klasifikimi sigurie;

13. **“Vizitorë”** nënkupton përfaqësuesit zyrtarë të një Pale, të cilët kërkojnë të vizitojnë mjediset e Palës tjetër të përfshirë në aktivitete, në lidhje me Informacionin ose materialin e Klasifikuar.

Neni 3

Nivelet e Klasifikimit të Sigurisë

1. Çdo Informacion i Klasifikuar i gjeneruar dhe/ose i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje

Faqe | 7480

shënjohe me nivelin e duhur të klasifikimit të sigurisë, sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të Palës që jep informacionin.

2. Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigurisë janë të barasvlershme në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme:

Për Republikën e Shqipërisë:	Për Dukatin e Madh të Luksemburgut
TEPËR SEKRET	TRÈS SECRET LUX
SEKRET	SECRET LUX
KONFIDENCIAL	CONFIDENTIEL LUX
I KUFIZUAR	RESTREINT LUX

3. Pala e Originës mund të përdorë shënjime shtesë që tregojnë kufizime të posaçme për përdorimin e Informacionit të Klasifikuar. Autoritetet Kombëtare të Sigurisë informojnë njëri-tjetrin në lidhje me këto shënjime shtesë.

Neni 4

Autoritetet Kombëtare të Sigurisë

1. Autoritetet Kombëtare të Sigurisë së Palëve janë:

Për Republikën e Shqipërisë
Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar
(Autoriteti Kombëtar i Sigurisë)

Për Dukatin e Madh të Luksemburgut:
Service de renseignement de l'État
Autorité Nationale de Sécurité

2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për ndryshimet e Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë. Ky njoftim nuk përbën ndryshim zyrtar të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 14, paragrafi 2.

3. Autoritetet Kombëtare të Sigurisë njoftojnë njëri-tjetrin në lidhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në shtetet e tyre, si dhe për çdo ndryshim që cenon mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar që gjenerohet ose shkëmbehet në pajtim me këtë Marrëveshjeje.

4. Me qëllim që të arrihen dhe ruhen standarde të krahueshme sigurie, Autoritetet Kombëtare të Sigurisë mund t'i japin njëri-tjetrit informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikën e sigurisë për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar që përdoret nga Pala Përkatëse.



Neni 5

Masat për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

1. Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, Palët marrin të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar që gjenerohet ose shkëmbehet sipas kësaj Marrëveshjeje. I njëjti nivel mbrojtjeje sigurohet për këtë Informacion të Klasifikuar siç parashikohet për Informacionin e Klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala e Origjinës informon Palën Marrëse me shkrim, në lidhje me çdo ndryshim të nivelit të klasifikimit të sigurisë të Informacionit të Klasifikuar të dhënë, me qëllim që të zbatojë masat e duhura mbrojtëse.

3. Informacioni i Klasifikuar bëhet i aksesueshëm vetëm për ata persona që kanë lejen e duhur në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme për të pasur akses në Informacionin e Klasifikuar të nivelit të barasvlershëm të klasifikimit të sigurisë që kanë nevojë për informim dhe që janë informuar sipas rrethanave.

4. Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë njeh Lejet e Sigurisë së Personelit dhe Strukturës të lëshuara nga Pala tjetër.

5. Autoritetet Kombëtare të Sigurisë mund të asistojnë njëri-tjetrin me kërkesë dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme në përmbushjen e procedurave të verifikimit/vetingut.

6. Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, Autoritetet Kombëtare të Sigurisë informojnë njëri-tjetrin pa vonesë në lidhje me revokimin e Lejeve të Sigurisë së Personelit dhe Strukturës ose ndryshimin e nivelit të klasifikimit të sigurisë.

7. Me kërkesën e Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Palës së Origjinës, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës Marrëse lëshon një konfirmim me shkrim që një individ është pajisur me Leje Sigurie Personeli ose një person juridik është pajisur me Leje Sigurie Struktura.

8. Pala marrëse:

a) nuk ia zbulon Informacionin e Klasifikuar një Pale të Tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës, të dhënë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme;

b) nëse konsiderohet e përshtatshme, e shënjon Informacionin e Klasifikuar të marrë në pajtim me ekuivalencën e përcaktuar në nenin 3;

c) nuk deklasifikon ose ul nivelin e Informacionit të Klasifikuar të dhënë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës;

d) e përdor Informacionin e Klasifikuar vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë.

Neni 6

Transferimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Informacioni i Klasifikuar transferohet nëpërmjet korrierëve diplomatikë ose ushtarakë ose me mjete të tjera të miratuara paraprakisht nga Autoritetet Kombëtare të Sigurisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

2. Transmetimi elektronik i Informacionit të Klasifikuar kryhet me mjete të certifikuara kriptografike, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

3. Nëse Informacioni i Klasifikuar i transferuar shënjohej SEKRET/SECRET LUX dhe më sipër, Pala Marrëse konfirmon marrjen me shkrim. Marrja e Informacionit tjetër të Klasifikuar konfirmohet me kërkesë.

4. Shërbimet e Sigurisë dhe Inteligjencës së Palëve mund të shkëmbejnë Informacion të Klasifikuar drejtpërdrejt, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

Neni 7

Riprodhimi dhe Përkthimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar TEPËR SEKRET/TRES SECRET LUX ose më sipër përkthehet ose riprodhohet vetëm në raste të jashtëzakonshme, me pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës.

2. Të gjitha riprodhimet dhe përkthimet e Informacionit të Klasifikuar shënjohehen me shënjime origjinale. Ky informacion i riprodhuar ose i përkthyer mbrohet në të njëjtën mënyrë si informacioni origjinal. Numri i riprodhimeve ose i përkthimeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare. Të gjitha përkthimet përmbajnë Informacion të Klasifikuar të Palës së Origjinës.



Neni 8

Asgjësimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar si 'TEPËR SEKRET'/TRES SECRET LUX nuk asgjësohet, përveç në rastet e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni. Ky Informacion i Klasifikuar i kthehet Palës së Origjinës pasi të çmohet i panevojshëm nga Palët.

2. Informacioni i klasifikuar SEKRET'/SECRET LUX ose më poshtë asgjësohet pasi të jetë njohur si i panevojshëm nga Pala Marrëse, në masën që pengon rindërtimin e plotë ose të pjesshëm.

3. Pala Marrëse njofton Palën e Origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar si SEKRET'/SECRET LUX.

4. Në rastin e një situatë krize që e bën të pamundur mbrojtjen ose kthimin e Informacionit të Klasifikuar të gjeneruar ose të shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje, Informacioni i Klasifikuar asgjësohet menjëherë. Pala Marrëse njofton Autoritetin Kombëtar të Sigurisë të të dyja Palëve, në lidhje me asgjësimin sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 9

Kontratat e Klasifikuara

1. Kontratat e Klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

2. Me kërkesë, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës Marrëse konfirmon se një Kontraktues ose nënkontraktues i propozuar është pajisur me një Leje të përshtatshme Sigurie Personeli ose Struktura. Nëse Kontraktuesi ose nënkontraktuesi i propozuar nuk e ka lejen e përshtatshme të sigurisë, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë i Palës së Origjinës mund t'i kërkojë Autoritetit Kombëtar të Sigurisë të Palës Marrëse lëshimin e lejes së përshtatshme të sigurisë.

3. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë në territorin e shtetit të të cilit duhet të përmbushet Kontrata e Klasifikuar, merr përgjegjësinë për parashikimin dhe zbatimin e masave të sigurisë për Kontratën e Klasifikuar sipas të njëjtave standarde dhe kërkesave që rregullojnë mbrojtjen e Kontratave të veta të Klasifikuara. Inspektimet periodike të sigurisë mund të kryhen nga Autoritetet Kombëtare të Sigurisë.

4. Një shtojcë për sigurinë do të jetë pjesë përbërëse e çdo Kontrate ose nënkontrate të Klasifikuar nëpërmjet së cilës Pala e Origjinës

përcakton se cili Informacion i Klasifikuar duhet t'i jepet Palës Marrëse, cili nivel i klasifikimit të sigurisë është caktuar për atë informacion dhe detyrimet e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit për të mbrojtur Informacionin e Klasifikuar. Një kopje e shtojcës së sigurisë i dërgohet Autoritetit Kombëtar të Sigurisë të Palës së Origjinës.

5. Para dhënies ndaj Kontraktuesve të Palës ose Kontraktuesve të mundshëm të çdo Informacioni të Klasifikuar të marrë nga Pala tjetër, Pala Marrëse, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e veta të brendshme, garanton që Kontraktuesit ose Kontraktuesit e mundshëm mund të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme sigurie për Informacionin e Klasifikuar dhe:

a) kryen një procedurë të përshtatshme për Lejen e Sigurisë së Strukturës për Kontraktuesit dhe Nënkontraktuesit;

b) përmbush një procedurë të përshtatshme Sigurie Personeli për të gjithë personelin, detyrat e të cilit kërkojnë akses tek Informacioni i Klasifikuar;

c) garanton që të gjithë personat që kanë akses tek Informacioni i Klasifikuar, të informohen në lidhje me përgjegjësitë e tyre;

d) kryen inspektime periodike sigurie të strukturave përkatëse me leje sigurie.

6. Nënkontraktuesit e përfshirë në Kontratat e Klasifikuara përmbushin kërkesat e sigurisë që zbatohen për Kontraktuesit.

7. Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë mund të vizitojnë njëri-tjetrin për të analizuar efikasitetin e masave të miratuara nga një Kontraktues ose nënkontraktues për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të përfshirë në një Kontratë të Klasifikuar.

Neni 10

Vizitat

1. Vizitat që kërkojnë akses në Informacionin e Klasifikuar, i nënshtrohen lejes paraprake nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë i Palës pritëse.

2. Kërkesa për vizitë paraqitet të paktën 3 javë para vizitës.

3. Kërkesa përmban:

a) emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes dhe kombësinë e vizitorit;

b) numrin e pasaportës ose një numër tjetër karte identiteti të vizitorit;



c) pozicionin e vizitorit dhe emrin e organizatës së përfaqësuar;

d) nivelin e Lejes së Sigurisë së Personelit të vizitorit dhe datën e skadimit;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrat e organizatave dhe strukturave që kërkohen të vizitohen;

g) numrin e vizitave dhe periudhës së kërkuar;

h) të dhëna të tjera të miratuara nga Autoritetet Kombëtare të Sigurisë.

3. Secila Palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

Neni 11

Shkelja e Sigurisë

1. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës Marrëse njofton menjëherë Autoritetin Kombëtar të Sigurisë së Palës së Originës, në lidhje me çdo dyshim ose zbulim të Shkeljes së Sigurisë dhe raporton rrethanat e shkeljes së sigurisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës Marrëse ndërmerr të gjitha masat e përshtatshme të mundshme në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme për të kufizuar pasojat e Shkeljes së Sigurisë dhe për të parandaluar shkelje të mëtejshme, si edhe për të garantuar hetimin e duhur.

Me kërkesë, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës së Originës ofron asistencë në hetim. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Palës Marrëse njofton me shkrim Autoritetin Kombëtar të Sigurisë së Palës së Originës, në lidhje me rezultatin e procedurave dhe masat korrigjuese të ndërmarra për shkak të kësaj shkeljeje.

Neni 12

Kostot

Secila Palë mbulon kostot e veta të shkaktuara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet Palëve dhe nuk i paraqitet asnjë gjykatë ndërkombëtare apo kombëtare.

2. Ndërkohë, Palët vijojnë të përmbushin dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Ndryshimet janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitën e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të denoncojë këtë Marrëveshje, duke i dërguar Palës tjetër njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje përfundon gjashtë muaj nga data në të cilën Pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, i gjithë Informacioni i Klasifikuar, i shkëmbyer në pajtim me këtë Marrëveshje, vijon të mbrohet në pajtim me dispozitat e përcaktuara në të dhe me kërkesë, i kthehet Palës së Originës.

Bërë në Luksemburg, më 25.6.2018, në dy kopje origjinale, secila në shqip, frëngjisht dhe anglisht, ku të gjithë tekstet janë njëllloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E
DUKATIT TË MADH TË
LUKSEMBURGUT

MINISTRI PËR
EVROPËN
DHE PUNËT E
JASHTME
Nënskrimi

MINISTRI PËR
EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Nënskrimi



DEKRET
Nr. 107, datë 2.4.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 15/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 17/2025

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT
PËR ZHVILLIM TË ABU DHABIT PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT
“SISTEMI I KAMERAVE NËN
ADMINISTRIMIN E POLICISË
SË SHTETIT – *SMART CITY*”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit për financimin e projektit “Sistemi i kamerave nën administrimin e Policisë së Shtetit – *Smart City*”,

sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 102, datë 27.3.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

Logo

**ADFD
FONDI PËR ZHVILLIM I ABU DHABIT**

**MARRËVESHJE HUAJE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT PËR ZHVILLIM TË ABU DHABIT –
ADFD, PËR FINANCIMIN E SISTEMIT TË
KAMERAVE NËN ADMINISTRIMIN E
POLICISË SË SHTETIT – *SMART CITY***

Shkurt 2025

Përmbajtja

- Marrëveshja e huas
- Përkufizimet
- Huaja dhe kushtet e huas
- Valuta
- Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave të huas
- Angazhime të veçanta
- Anulimi dhe pezullimi
- Zbatueshmëria e kësaj marrëveshjeje; mosushtrimi i të drejtave; arbitrazhi
- Të ndryshme
- Data e hyrjes në fuqi, ndërprerja
- Adresat

MARRËVESHJE HUAJE

Sot, e martë, më 13.2.2025 dhe në Abu Dhabi, është lidhur kjo marrëveshje nga dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Financave (në vijim i



referuar si **huamarrësi**) dhe Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit (në vijim i referuar si **ADFD**-ja),

duke pasur parasysh se Huamarrësi i ka kërkuar ADFD-së që të marrë pjesë në financimin e Sistemit të Kamerave nën administrimin e Policisë së Shtetit – *Smart City*, siç përshkruhet hollësisht në skedulin II të kësaj marrëveshjeje (në vijim i referuar si Projekti); dhe

duke pasur parasysh se ADFD-ja synon të ndihmojë vendet arabe, afrikane, aziatike dhe vende të tjera në zhvillim, për zhvillimin e ekonomisë së tyre, duke u dhënë atyre huat e nevojshme për realizimin e projekteve të zhvillimit; dhe

duke pasur parasysh se ADFD-ja është e bindur për qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e projektit dhe rëndësinë e projektit për zhvillimin e ekonomisë së huamarrësit; dhe

duke pasur parasysh se ADFD-ja, në bazë të sa më sipër, ka rënë dakord t'i japë huamarrësit një hua në bazë të termave dhe kushteve të përfshira në këtë marrëveshje,

tashmë, si rrjedhojë, palët bien dakord, si më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet

1. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme, kudo që përdoren në këtë marrëveshje ose në ndonjë skedul të kësaj marrëveshjeje:

a) “**Huamarrës**” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave;

b) Termi “**Projekt**” nënkupton projektin ose projektet, ose programin, ose programet për të cilat jepet huaja, siç përshkruhet në skedulin II të kësaj marrëveshjeje, dhe si përshkrimi i saj ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet ADFD-së dhe huamarrësit;

c) Termi “**Mallra**” nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet e nevojshme për projektin. Kudo që i referohet koston së mallrave, kjo kosto do të konsiderohet se përfshin koston e importimit të këtyre mallrave në territoret e huamarrësit;

d) Termi “**Përfitues**” nënkupton Ministrinë e Brendshme të qeverisë së Shqipërisë.

Neni 2

Huaja dhe kushtet e huas

1. ADFD-ja pranon t'i japë hua huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të specifikuar ose të përfshira me referencë në këtë marrëveshje, një shumë prej 118,500,000 \$ (dollarë amerikanë).

2. Huamarrësi do të paguajë interes në normën katër për qind (4%) në vit mbi shumën e principalit të huas së tërhequr dhe të pushlyer. Interesi do të akumulohet nga datat përkatëse në të cilat tërhiqen shumat.

3. Huamarrësi do të shlyejë principalin e huas në përputhje me skedulin e amortizimit të specifikuar në skedulin I të kësaj marrëveshjeje, mbi bazën që periudha e shlyerjes do të jetë 15 vjet, përfshirë 3 vjet si periudhë mospagimi.

4. Interesi dhe tarifat e tjera do të paguhet çdo gjashtë muaj, më 14 shkurt dhe 14 gusht të çdo viti.

5. Huamarrësi ka të drejtën, pas kryerjes së pagesës së të gjithë interesit të shtuar dhe të gjitha tarifave të tjera, dhe pas njoftimit për ADFD-në jo më pak se 45 ditë para, që të shlyejë përpara maturimit:

a) totalin e shumës së principalit të huas në kohën e duhur; ose

b) pjesën e shumës së principalit të huas në kohën e duhur.

6. Principali, interesi dhe detyrimet e tjera mbi huan do të paguhet në Abu Dhabi ose në vende të tilla që ADFD-ja do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Neni 3

Valuta

1. Tërheqja e të ardhurave të huas, shlyerja e saj, pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera, dhe të gjitha llogaritë e transaksioneve financiare, në lidhje me këtë marrëveshje, do të bëhen në dollarë amerikanë.

2. ADFD-ja, me kërkesë të huamarrësit dhe duke vepruar si agjent i tij, do të blejë çdo valutë që huamarrësit i nevojitet për pagesën ose rimbursimin e koston së mallrave të financuara nga huaja, në përputhje me këtë marrëveshje. Shuma e konsideruar si e tërhequr nga huaja në këtë rast do të jetë e barabartë me shumën në dollarë amerikanë që nevojitet për blerjen e kësaj valute të huaj.



3. ADFD-ja, me kërkesë të huamarrësit dhe duke vepruar si agjent i tij, mund të blejë një shumë të tillë në dollarë amerikanë, e cila mund të kërkohej për shlyerjen, në përputhje me seksionin 1 të këtij neni, në çdo valutë ose valuta të huaja të pranueshme për ADFD-në.

4. Kurdoherë që kërkohej për qëllime të kësaj marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një valute për sa i përket një tjetre, kjo vlerë do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga ADFD-ja.

Neni 4

Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave të huas

1. Huamarrësit i jepet e drejta të tërheqë nga huaja shuma që nevojiten në përputhje me këtë marrëveshje.

2. Asnjë shumë nuk mund të tërhiqet nga huaja për llogari të shpenzimeve të kryera përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, përveç kur ADFD-ja bie dakord ndryshe.

3. Me kërkesë të huamarrësit dhe në terma, dhe kushte që do të dakordësohen ndërmjet huamarrësit dhe ADFD-së, kjo e fundit mund të hyjë në angazhime të veçanta me shkrim, për t'i paguar huamarrësit ose palëve të tjera shuma në lidhje me koston e mallrave që do të financohen sipas kësaj marrëveshjeje, duke mos kundërshtuar asnjë pezullim ose anulim.

4. Kur huamarrësi dëshiron të tërheqë ndonjë shumë nga huaja ose t'i kërkojë ADFD-së që të hyjë në një angazhim të veçantë në bazë të seksionit të mësipërm, huamarrësi do t'i paraqesë ADFD-së një kërkesë në formularët e identifikuar nga ADFD-ja, të shoqëruar me dokumentet e nevojshme mbështetëse, në mënyrë që kurdoherë kur kryhet ndonjë tërheqje ose merret një angazhim i veçantë përpara se një kërkesë e tillë, ose dokumente të tilla mbështetëse t'i paraqiten ADFD-së, ato do të paraqiten menjëherë më pas.

5. Çdo aplikim për tërheqje dhe dokumentet shoqëruese mbështetëse, dhe dëshmitë e tjera duhet të jenë të përshtatshme në formë dhe përmbajtje, sipas kërkesave të ADFD-së. Huamarrësi ka të drejtë që të tërheqë nga huaja shumën për të cilën ka aplikuar dhe se shuma që do të tërhiqet nga huaja do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë marrëveshje.

6. Huamarrësi do të zbatojë të ardhurat e huas ekskluzivisht për financimin e koston së arsyeshme

të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për të realizuar projektin, siç përshkruhet në shtojcën II, në përputhje me prokurimet dhe procedurat e ADFD-së, e cila do të njoftojë huamarrësin dhe përfituesin nëpërmjet korrespondencës zyrtare.

7. Huamarrësi siguron që të gjitha mallrat e financuara nga të ardhurat e huas janë vetëm për realizimin e projektit.

8. Pagesa, nga ana e ADFD-së, e shumave që huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja, do të bëhet për ose me porosi të huamarrësit.

9. E drejta e huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të përfundojë më 31.12.2029 ose në një datë tjetër që mund të dakordësohet herë pas here ndërmjet huamarrësit dhe ADFD-së.

Neni 5

Angazhime të veçanta

1. Huamarrësi do t'i vendosë të ardhurat e huas në dispozicion të përfituesit, në terma dhe kushte të pranueshme për ADFD-në.

2. Huamarrësi dhe përfituesi do të ngarkohen me realizimin dhe administrimin e projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe në pajtim me kërkesat e menaxhimit të shërbimeve publike, dhe në linjë me parimet e qëndrueshme inxhinierike, financiare dhe teknike.

3. Për zbatimin e efektshëm të projektit, huamarrësi nëpërmjet përfituesit do të marrë masat e nevojshme dhe brenda gjashtë javëve nga data e marrëveshjes ose në një datë tjetër që mund të dakordësohet me ADFD-në, për krijimin e një njësie për zbatimin e projektit (NJZP), që do të jetë përgjegjëse për administrimin e realizimit të projektit. NJZP-ja do të drejtohet nga një inxhinier i kualifikuar dhe me përvojë, i pranueshëm për ADFD-në, dhe do të përbëhet nga punonjës kompetentë teknikë, të kontabilitetit dhe administrativë vendas, sipas pritshmërisë së ADFD-së. Huamarrësi, nëpërmjet përfituesit, në interesin më të mirë të projektit, do t'i ofrojë NJZP-së burimet, financimin dhe lehtësitë e duhura dhe do t'i ngarkojë përgjegjësitë e nevojshme për të garantuar që të ruhen kërkesat e duhura të koordinimit dhe ndërldhjes për realizimin e suksesshëm të punimeve të projektit.

4. Gjatë kryerjes së punimeve dhe mbikëqyrjes së projektit, huamarrësi nëpërmjet përfituesit ose përfituesi do të punësojnë, ose do të sigurojnë që të



punësohen konsulentë inxhinierë (ose konsulentë të tjerë sipas nevojës) të pranueshëm për, dhe sipas termave dhe kushteve të ADFD-së.

5. Huamarrësi dhe/ose përfituesi do t'i japin ADFD-së kopje të certifikuara të të gjitha kontratave të lidhura përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në lidhje me realizimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

6. Dhënia e kontratave për realizimin dhe mbikëqyrjen e projektit do t'i nënshtrohet miratimit të ADFD-së.

7. Huamarrësi ose përfituesi do të marrë masat e duhura për të fituar pronësinë mbi tokën ose të drejtat mbi të, sipas kërkesave të realizimit të projektit.

8. Nëse shumat e alokuara për financimin e projektit janë më të ulëta sesa kostoja e parashikuar e realizimit, huamarrësi dhe përfituesi do të ndërmarrin hapat që mund të jenë të nevojshëm për të siguruar shumat shtesë të nevojshme për përfundimin e realizimit.

9. Huamarrësi dhe përfituesi do t'i paraqesin ADFD-së, menjëherë pas përgatitjes së tyre, studimet, planet dhe specifikimet e projektit, dhe skedulet e realizimit të tij, si dhe çdo ndryshim material që mund të bëhet më pas në to, në një mënyrë të tillë siç ADFD-ja do të kërkojë herë pas here.

10. Huamarrësi dhe përfituesi do të mbajnë ose do të sigurojnë që të mbahen të dhëna të përshtatshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e huas, dhe të informojë për përdorimin e tyre në projekt, të tregojë progresin e projektit (përfshirë kostot e tij) dhe të pasqyrojë, në pajtim me procedurat e duhura që janë në përputhje me praktikën e qëndrueshme dhe të mirëkrijuara të kontabilitetit, veprimet dhe gjendjen financiare të autoritetit që kryen projektin. Huamarrësi dhe përfituesi do t'u japin përfaqësuesve të akredituar të ADFD-së të gjitha mundësitë e arsyeshme që të kryejnë vizita për qëllime që lidhen me huan, të kontrollojnë progresin e punës, dhe të shqyrtojnë çdo të dhënë dhe dokument përkatës, dhe do t'i japin ADFD-së të gjithë informacionin që ADFD-ja do të kërkojë, në lidhje me shpenzimet e të ardhurave të huas, realizimin e projektit dhe gjendjen financiare të huamarrësit.

11. Huamarrësi dhe përfituesi marrin përsipër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, që të

drejtojnë dhe mbajnë projektin, si dhe shtojca të tilla, që nuk janë pjesë përbërëse e projektit, të nevojshme për funksionimin e duhur të tij, në përputhje me parimet e qëndrueshme inxhinierike, financiare dhe teknike.

12. Huamarrësi dhe përfituesi, dhe ADFD-ja do të bashkëpunojnë për të përmbushur kërkesat e ADFD-së, nga kuadri logjik për monitorimin dhe vlerësimin, siç specifikohet në skedulin III të kësaj marrëveshjeje.

13. Huamarrësi dhe përfituesi, dhe ADFD-ja do të bashkëpunojnë plotësisht për të garantuar që qëllimet e huas do të përmbushen. Për këtë qëllim, secila palë merr përsipër t'i japë palës tjetër informacione dhe deklarata që ajo palë mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me gjendjen e përgjithshme të huas. Huamarrësi dhe përfituesi, dhe ADFD-ja do të shkëmbejnë herë pas here pikëpamjet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, mbi çështjet që lidhen me qëllimet e huas dhe ruajtjen e përdorimit të saj. Huamarrësi, nëpërmjet përfituesit, do të informojë menjëherë ADFD-në për çdo kusht që ndërhyt ose rrezikon të ndërhyjë në përmbushjen e qëllimit të huas (duke përfshirë çdo rritje të dukshme në koston e projektit).

14. Huamarrësi dhe përfituesi, dhe ADFD-ja synojnë reciprokisht që asnjë borxh tjetër i jashtëm të mos ketë përparësi mbi huan, me anë të pengut/barrës të krijuar më pas mbi asetet e huamarrësit. Për këtë qëllim, huamarrësi merr përsipër që, me përjashtim të rasteve kur ADFD-ja bie dakord ndryshe, nëse mbi ndonjë aset të huamarrësit krijohet ndonjë barrë si garanci për këtë borxh të jashtëm, kjo barrë do të sigurojë, *ipso facto* në mënyrë të barabartë dhe të arsyeshme, pagesën e principalit të, dhe interesit dhe tarifave të tjera mbi huan, dhe se për krijimin e një barre të tillë do të merren masa të shprehura për këtë qëllim, megjithatë, me kusht që dispozitat e mësipërme të këtij neni nuk do të zbatohen për:

a) ndonjë barrë të krijuar mbi pronën në kohën e blerjes së saj vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së një prone të tillë;

b) ndonjë barrë mbi mallrat tregtare për të siguruar një borxh që nuk maturohet më shumë se një vit pas datës në të cilën është krijuar fillimisht dhe që do të paguhet nga të ardhurat e shitjes së këtyre mallrave tregtare;

c) ndonjë barrë që krijohet në ecurinë e zakonshme të transaksioneve bankare dhe që



siguron një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

15. Principali dhe interesi mbi huan, dhe të gjitha tarifat e tjera paguhen pa zbritje dhe lirisht, dhe të çliruara nga çdo taksë në fuqi, në bazë të ligjeve të huamarrësit.

16. Kjo marrëveshje huaje nuk do të jetë objekt i asnjë takse, tarife dhe detyrimi të çfarëdo natyre, që mund të vendoset në bazë të ndonjë ligji në fuqi në vendin e huamarrësit, mbi ose në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e saj, dhe huamarrësi do të paguajë ose do të sigurojë që të paguhen të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet, nëse ka, të vendosura në bazë të ligjeve në fuqi në çdo vend në valutën e të cilit huaja është e pagueshme.

17. Principali, interesi dhe detyrimet e tjera mbi huan do të paguhen lirisht, pa kufizimet e vendosura në bazë të ligjeve në fuqi në vendin e huamarrësit.

18. Huamarrësi, nëpërmjet përfituesit, siguron ose merr masa që të sigurohen te siguruesit përgjegjës të gjithë mallrat e financuar nga të ardhurat e huas. Një sigurim i tillë do të mbulojë rreziqe të tilla detare, tranziti dhe të tjera, të rastësishme për blerjen dhe importimin e mallrave në territoret e huamarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e projektit, dhe do të jetë për shumën të tilla që do të jenë në pajtim me praktikën e qëndrueshme tregtare. Një sigurim i tillë do të paguhet në valutën në të cilën do të paguhet kostoja e mallrave të siguruara aty ose në valutë lirisht të konvertueshme. Huamarrësi, nëpërmjet përfituesit, do të marrë dhe mbajë ose do të sigurojë që të merret dhe mbahet, me siguruesit përgjegjës, sigurimi kundër rreziqeve që lidhen me projektin në shumën të tilla që do të jenë në pajtim me praktikën e qëndrueshme tregtare.

19. Huamarrësi dhe përfituesi do të ndërmarrin ose do të sigurojnë që të ndërmerren të gjitha veprimet që do të jenë të nevojshme nga ana e tyre për të realizuar projektin dhe nuk do të ndërmarrin ose lejojnë që të ndërmerret asnjë veprim që do të pengonte ose ndërhynte në realizimin, ose funksionimin e projektit, ose zbatimin e ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

20. Huamarrësi, nëpërmjet përfituesit, merr përsipër të sigurojë të gjitha metodat e komunikimit dhe mjetet moderne teknologjike për të ndjekur progresin dhe zbatimin e të gjitha fazave të projektit deri në përfundimin e tij, në koordinim me ADFD-në.

21. Të gjitha dokumentet, të dhënat, letërkëmbimi dhe materiale të ngjashme të ADFD-së do të konsiderohen nga huamarrësi si çështje konfidenciale. Huamarrësi dhe përfituesi do t'i japin ADFD-së imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i publikimeve.

22. Të gjitha asetet dhe të ardhurat e ADFD-së nuk do të jenë objekt i shpronësimeve, konfiskimit dhe sekuestrimit.

Neni 6

Anulimi dhe pezullimi

1. Huamarrësi, me një njoftim për ADFD-në, mund të anulojë çdo shumë të huas të cilën huamarrësi nuk e ka tërhequr përpara dërgimit të një njoftimi të tillë, përveç që huamarrësi nuk mund të anulojë asnjë shumë të huas, në lidhje me të cilën ADFD-ja ka hyrë në një angazhim të veçantë, në bazë të seksionit 3, të nenit 4 të kësaj marrëveshjeje.

2. Nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme ndodh dhe vazhdon, ADFD-ja, me një njoftim për huamarrësin, mund të pezullojë tërheqjet nga ana e huamarrësit të ndonjë shume nga huaja:

a) ka ndodhur një rast moskryerjeje pagese, tërësisht ose pjesërisht, të principalit ose interesit, ose ndonjë pagese tjetër të nevojshme nën këtë marrëveshje, ose ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje, ndërmjet huamarrësit dhe ADFD-së;

b) ka ndodhur mospërmbushje e ndonjë angazhimi ose marrëveshjeje tjetër nga ana e huamarrësit nën këtë marrëveshje;

c) ADFD-ja ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e huamarrësit për të kryer tërheqje nën ndonjë marrëveshje tjetër huaje ndërmjet huamarrësit dhe ADFD-së, për shkak të një mospërmbushjeje nga ana e huamarrësit;

d) është krijuar një situatë e jashtëzakonshme e cila do ta bëjë të pamundur për huamarrësin që të përmbushë detyrimet e tij nën këtë marrëveshje. Çdo rast i tillë që mund të ketë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të ketë të njëjtin efekt që do të kishte nëse do të kishte ndodhur pas saj.

3. E drejta e huamarrësit për të kryer tërheqje në bazë të huas do të vijojë të pezullohet tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa rasti ose rastet që kanë shkaktuar një pezullim të tillë të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa ADFD-ja të ketë njoftuar huamarrësin se e drejta për të kryer tërheqje është



rivendosur, megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi të tillë për rivendosje, e drejta për të kryer tërheqje do të rivendoset vetëm në masën dhe sipas kushteve të specifikuara në këtë njoftim, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose cenojë asnjë të drejtë, tagër ose mjet juridik të ADFD-së, në lidhje me ndonjë rast tjetër të mëvonshëm të përshkruar në këtë seksion.

4. Nëse ka ndodhur ndonjë rast i specifikuar në paragrafin 2 “a” të seksionit të mësipërm dhe do të vijojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pasi njoftimi lidhur me të t’i jetë dhënë huamarrësit nga ADFD-ja ose nëse ka ndodhur ndonjë rast i specifikuar në paragrafët 2 “b”, “c” dhe “d”, të seksionit në fjalë, dhe do të vijojë për një periudhë prej nëntëdhjetë ditësh pasi njoftimi lidhur me të t’i jetë dhënë huamarrësit nga ADFD-ja, atëherë, në çdo moment të mëvonshëm gjatë vijimit të saj, ADFD-ja, sipas gjykimit të saj, mund të deklarojë principalin e huas, të kërkueshëm dhe të pagueshëm menjëherë; dhe pas çdo deklarate të tillë, ky principal do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm, pavarësisht nëse ndonjë nen tjetër në këtë marrëveshje parashikon ndryshe.

5. Nëse e drejta e huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja është pezulluar në lidhje me ndonjë shumë të saj për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh ose deri në datën e specifikuar në seksionin 9, të nenit 4, si datë mbylljeje, një shumë e huas do të mbetet e patërhequr, me njoftim për huamarrësin, ADFD-ja mund të ndërpresë të drejtën e huamarrësit për të kryer tërheqje në lidhje me këtë shumë. Me dhënien e një njoftimi të tillë, kjo shumë e huas do të anulohet.

6. Asnjë anulim ose pezullim nga ADFD-ja nuk do të zbatohet për shumat që i nënshtrohen ndonjë angazhimi të veçantë të marrë nga ADFD-ja, në përputhje me seksionin 3, të nenit 4, përveç siç parashikohet shprehimisht në këtë angazhim.

7. Çdo anulim do të zbatohet në mënyrë të barabartë proporcionalisht me maturimin e pashlyer të shumës së principalit të huas, njësoj siç përcaktohet në skedulin e amortizimit nr. 1 të kësaj marrëveshjeje.

8. Pavarësisht nga ndonjë anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të vijojnë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç siç parashikohet specifikisht në këtë nen.

Neni 7

Zbatueshmëria e kësaj marrëveshjeje; mosushtrimi i të drejtave; arbitrazhi

1. Të drejtat dhe detyrimet e huamarrësit dhe ADFD-së nën këtë marrëveshje do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga ndonjë ligj vendas për të kundërtën. As huamarrësi, as ADFD-ja nuk do të kenë të drejtë, në asnjë rrethanë, që të pretendojnë se ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për çfarëdo arsye.

2. Mosushtrimi i ndonjë të drejte ose kompetence të dhënë secilës palë nga ndonjë dispozitë në këtë marrëveshje, nuk do ta pengojë atë që të ushtrojë këtë të drejtë ose tagër në ndonjë moment të mëvonshëm dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj. Gjithashtu, asnjë lëshim i treguar nga njëra palë, në lidhje me ndonjë mospërmbushje të kryer nga pala tjetër, nuk do të pengojë atë palë që të ushtrojë më pas ndonjë veprim të lejueshëm për atë palë nën këtë marrëveshje, në lidhje me këtë mospërmbushje.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në këtë marrëveshje dhe çdo pretendim nga secila palë kundër palës tjetër që lind nën këtë marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse një mirëkuptim i tillë nuk është i mundur, mosmarrëveshja ose pretendimi do të referohet për zgjidhje nga një Gjykatë Arbitrazhi, në përputhje me dispozitat e mëposhtme të këtij neni.

a) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tri arbitra, ku njëri do të caktohet nga huamarrësi, arbitri i dytë nga ADFD-ja dhe arbitri i tretë (në vijim i referuar si Gjykatësi i Arbitrazhit) do të caktohet me marrëveshje të palëve. Nëse palët nuk bien dakord brenda 60 ditëve nga fillimi i procedurave të arbitrazhit, Gjykatësi i Arbitrazhit do të caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe, me kërkesën e secilës prej palëve. Nëse palët nuk arrijnë secila që të caktojnë arbitrin e vet, Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe do të caktojë arbitrin me kërkesën e palës tjetër. Në rast të dorëheqjes, vdekjes ose paaftësisë për veprim të ndonjë arbitri, do të caktohet një pasues në të njëjtën mënyrë në të cilën është caktuar arbitri fillestar;

b) Procedurat e arbitrazhit mund të fillojnë nga secila palë, duke i dhënë njoftim palës tjetër, ku njoftimi përmban argumentimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes ose pretendimit që do t’i paraqitet



arbitrazhit, natyrës dhe nivelit të lehtësimit të kërkuar dhe emrin e arbitrit të caktuar nga pala që ka iniciuar procedurat e arbitrazhit. Brenda tridhjetë ditëve pas dërgimit të një njoftimi të tillë, pala do të njoftojë palën tjetër për emrin e arbitrit të vet. Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në orën dhe vendin që do të vendoset nga Gjykatësi i Arbitrazhit. Më pas, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë mbi vendin dhe orën kur do të mblidhet;

c) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë procedurën e vet, në mënyrë që secilës palë t'i mundësohet një seancë e drejtë gjyqësore. Gjykata e Arbitrazhit mund të marrë vendim për çështjet e paraqitura ose në prani të palëve, ose në mungesë. Të gjitha vendimet e tij merren me shumicë votash. Vendimi jepet me shkrim dhe nënshkruhet të paktën nga një shumicë e Gjykatës së Arbitrazhit. Secilës palë i transmetohet një kopje e nënshkruar e vendimit. Çdo vendim i tillë, i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij neni, do të jetë i formës së prerë dhe ligjërishit i detyrueshëm për palët e kësaj marrëveshjeje. Secila palë do të veprojë sipas rregullave dhe do të pajtohet me çdo vendim të tillë të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit;

d) Gjykata e Arbitrazhit do të zbatojë parimet e përbashkëta sipas ligjeve aktuale të huamarrësit dhe të shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, si dhe parimet e drejtësisë dhe ndërgjegjes së mirë;

e) Secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta në procedurën e arbitrazhit, duke përfshirë tarifat e arbitrit të caktuar prej tij. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit dhe tarifat e Gjykatësit të Arbitrazhit do të ndahen dhe do të mbulohen në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo çështje në lidhje me ndarjen e kostove të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedurën për pagesën e këtyre kostove, do të vendoset nga Gjykata e Arbitrazhit.

4. Dispozitat e arbitrazhit, të specifikuara në seksionin e mësipërm, do të kenë përparësi në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve në këtë marrëveshje dhe ndonjë pretendim nga secila palë ndaj palës tjetër që krijohet sipas marrëveshjes.

5. Dërgimi i çdo njoftimi ose procesi, në lidhje me ndonjë procedim sipas këtij neni, mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 1, të nenit 8.

Neni 8

Të ndryshme

1. Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet, ose të bëhet nën këtë marrëveshje, do të jetë me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionin 3, të nenit 9, një njoftim ose kërkesë e tillë çmohet se është dhënë ose bërë sipas rregullave kur dorëzohet dorazi, me postë ose postë elektronike, palës së cilës duhet ose lejohet t'i jepet ose bëhet në adresën e kësaj pale të specifikuar në këtë marrëveshje, ose në ndonjë adresë tjetër që kjo palë ka përcaktuar me një njoftim për palën tjetër.

2. Huamarrësi do t'i japë ADFD-së dëshmi të mjaftueshme për tagrin e personit ose personave që do të nënshkruajnë kërkesat e parashikuara në nenin 4 ose që, në emër të huamarrësit, do të ndërmarrin ndonjë veprim tjetër ose do të ekzekutojnë ndonjë dokument tjetër që kërkohet ose lejohet të merret ose ekzekutohet nga huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje, dhe nënshkrimin model të vërtetuar të secilit person të tillë.

3. Çdo veprim që kërkohet ose lejohet të ndërmerret dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet, sipas kësaj marrëveshjeje, në emër të huamarrësit, mund të ndërmerret ose ekzekutohet nga ministri i Financave i huamarrësit ose ndonjë person i autorizuar prej tij me shkrim. Për çdo ndryshim ose plotësim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje mund të bihet dakord në emër të huamarrësit me instrument me shkrim të ekzekutuar në emër të huamarrësit nga përfaqësuesi i tij.

4. Çdo marrëveshje mbështetëse e shkëmbyer ndërmjet palëve, në lidhje me ose në zbatim të kësaj marrëveshjeje, do të përbëjë detyrim ligjor për të njëjtën efekt sikur të ishte përfshirë këtu.

5. Gjuha sipas së cilës do të interpretohet kjo marrëveshje, është gjuha angleze.

Neni 9

Data e hyrjes në fuqi, ndërprerja

1. Kjo marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa fondit t'i jenë dhënë dëshmi të duhura:

A) vlerësimi teknik dhe financiar për projektin nga fondi dhe dërgimi i vlerësimit përfundimtar në Bordin e Drejtorëve të Fondit për miratim;

B) ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj marrëveshjeje në emër të huamarrësit është autorizuar dhe



ratifikuar sipas rregullave nga të gjitha veprimet e nevojshme kushtetuese.

2. Si pjesë të dëshmive që duhet të jepen në përputhje me seksionin e mësipërm, huamarrësi do t'i japë ADFD-së një opinion të një autoriteti kompetent, që tregon se kjo marrëveshje është autorizuar sipas rregullave, ratifikuar nga, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të huamarrësit, dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish të detyrueshëm për huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

3. Nëse ADFD-ja është e bindur me dëshmitë e dhëna nga huamarrësi, në lidhje me efektin ligjërish të detyrueshëm të kësaj marrëveshjeje, ADFD-ja do t'i dërgojë huamarrësit me letër, njoftimin për pranimin e dëshmive të kërkuara. Kjo marrëveshje do të jetë efektive dhe hyn në fuqi në datën në të cilën dërgohet kjo letër.

4. Nëse të gjitha veprimet që duhet të kryhen, në bazë të seksionit 1 të këtij neni, nuk janë kryer përpara 180 ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ose në ndonjë datë tjetër për të cilën ADFD-ja dhe huamarrësi do të dakordësohen, ADFD-ja mund të ndërpresë këtë marrëveshje në çdo kohë më pas, sipas opsionit të tij, me njoftim për huamarrësin. Me dhënien e një njoftimi të tillë, kjo marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve nën marrëveshje ndërpriten menjëherë.

5. Nëse dhe kur e gjithë shuma e principalit të huas, dhe të gjitha interesat dhe tarifat e tjera që do t'i jenë shtuar huas të jenë paguar, kjo marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të ndërpriten menjëherë.

Neni 10

Adresat

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e nenit 8, seksioni 1:

Skeduli I

Skeduli i amortizimit të marrëveshjes së huas

Shlyerja nr.	Data e kësteve të kërkueshme	Shuma totale e kësteve të kërkueshme (pa përfshirë interesin)
1	14 gusht 2028	4,937,500.00
2	14 shkurt 2029	4,937,500.00
3	14 gusht 2029	4,937,500.00
4	14 shkurt 2030	4,937,500.00
5	14 gusht 2030	4,937,500.00
6	14 shkurt 2031	4,937,500.00
7	14 gusht 2031	4,937,500.00
8	14 shkurt 2032	4,937,500.00

PËR HUAMARRËSIN:

SH.T. Petrit Malaj

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë
Shqipëri

Republika e Shqipërisë

Email: sekretariamin@finance.gov.al

PËR ADFD-në:

Fondi për Zhvillim i Abu Dhabit

P. O. Box 814, Abu Dhabi, U.A.E

Tel: 971-2-6677100

Faks: 971-2-6677070

Email: operations@adfd.ac

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj marrëveshjeje që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë siguruar që kjo marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës dhe të dorëzohet në dy kopje origjinale, secila e konsideruar origjinale dhe të gjitha me efekt të njëjtë dhe të vetëm, në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

PËR HUAMARRËSIN
PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

SH.T. Petrit Malaj
Nënshkrimi
Ministër i Financave

PËR FONDIN PËR
ZHVILLIM TË ABU
DABIT

Mohammed Saif Al Sucaid
Nënshkrimi
Drejtor i Përgjithshëm



9	14 gusht 2032	4,937,500.00
10	14 shkurt 2033	4,937,500.00
11	14 gusht 2033	4,937,500.00
12	14 shkurt 2034	4,937,500.00
13	14 gusht 2034	4,937,500.00
14	14 shkurt 2035	4,937,500.00
15	14 gusht 2035	4,937,500.00
16	14 shkurt 2036	4,937,500.00
17	14 gusht 2036	4,937,500.00
18	14 shkurt 2037	4,937,500.00
19	14 gusht 2037	4,937,500.00
20	14 shkurt 2038	4,937,500.00
21	14 gusht 2038	4,937,500.00
22	14 shkurt 2039	4,937,500.00
23	14 gusht 2039	4,937,500.00
24	14 shkurt 2040	4,937,500.00
Total		118,500,000.00
Totali në dollarë amerikanë (NJËQIND E TETËMBËDHJETË MILIONË E PESËQIND MIJË)		

Skeduli II

1. Objektivat e projektit

Projekti synon të forcojë infrastrukturën teknike në Republikën e Shqipërisë, për të garantuar një mjedis të sigurt dhe inteligjent, duke përfituar nga teknologjitë e inteligjencës artificiale. Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e sigurisë publike dhe përmirësimi i performancës së punonjësve të Policisë, duke instaluar sisteme elektronike për monitorimin dhe kontrollin më të efektshëm të territorit, si dhe ofrimin e informacionit të nevojshëm për parandalimin dhe/ose zgjidhjen e incidenteve.

2. Përshkrimi i projektit

Projekti përfshin sigurimin dhe instalimin e platformave të inteligjencës artificiale për menaxhimin e qytetit dhe trafikut, përveç një qendre të avancuar kontrolli. Projekti përfshin instalimin e radarëve të shpejtësisë dhe kamerave monitoruese për të përmirësuar sigurinë rrugore, përditësimin e kamerave ekzistuese dhe instalimin e fibrave optike për lidhje më të mirë me internetin, duke përfshirë shërbime profesionale dhe mbështetje, dhe mirëmbajtje për 4 vjet.

3. Lista e mallrave

Komponentët	Shuma (USD/ dollarë amerikanë)	Përqindja e financimit
1. Licencat e softuerit	31,130,000	100%
2. Hardueri dhe infrastruktura	62,400,000	100%
3. Shërbime profesionale	7,840,000	100%
4. Mbështetje dhe mirëmbajtje për 4 vjet	17,130,000	100%
Totali	118,500,000	

Skeduli nr. III: (kuadri logjik i ADFD-së për monitorimin dhe vlerësimin)

Zinxhiri i rezultateve	Indikatorët e performancës	Baza	Burimi i të dhënave dhe mekanizmi i raportimit
	Rezultati		
	Produktet		



DEKRET
Nr. 102, datë 27.3.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 17/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të *Abu Dhabi*-t, për financimin e projektit ‘Sistemi i kamerave nën administrimin e Policisë së Shtetit – *Smart City*’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 21/2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 10 416, DATË 7.4.2011,
“PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE
SHUMËZUES BIMOR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj:

- a) fjala “furnizues” zëvendësohet me fjalët “operator profesionist”;
- b) fjala “fillestar” zëvendësohet me fjalët “para-bazë”;

c) emërtesa “Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRRKK)” zëvendësohet me emërtesën “Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)”;

ç) fjala “sekuestrim” zëvendësohet me fjalën “bllokim”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:

“12/1. “Material mbjellës i certifikuar jo përfundimisht” është një varietet, që është i regjistruar në KK, por jo i ambalazhuar dhe i etiketuar, e që importohet i hapur.”.

2. Pas pikës 22 shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:

“22/1. “Vendosje në treg” janë veprime të kryera nga një operator profesionist, si: shitje, mbajtje, transferim falas ose ofertë për shitje ose çdo mënyrë tjetër transferimi ose shpërndarje brenda vendit ose importi nga vendet e tjera.”.

Neni 3

Në nenin 4 pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“8/1. Të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor e ka çdo person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie prodhimin, importin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që i paraqet dokumentacionin institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg, si më poshtë:

a) diplomë “Bachelor” ose “Master” të drejtuesit teknik në fushën e agronomisë ose në fushën e inxhinierisë së pyjeve për rastet e materialit mbjellës pyjor;

b) kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit teknik.”.

Neni 4

Në nenin 5 pika 2 shfuqizohet.

Neni 5

Në pikën 2 të nenit 7, në pikën 3 të nenit 15, në pikën 4 të nenit 17, në pikën 1 të nenit 18 dhe në



pikën 5 të nenit 19 fjalët “përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit” zëvendësohen me fjalët “miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për pyjet dhe kullotat”.

Neni 6

Në nenin 10 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, ESHFF-ja lejon tregtimin nëse rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është i regjistruar.”.

Neni 7

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “b” fjala “AKU-së” zëvendësohet me fjalët “institucioni përgjegjës për shërbimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor dhe shëndetit të bimëve”;

b) në shkronjat “dh” dhe “e”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “për certifikim.”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Çdo subjekt publik dhe/ose privat me objekt veprimtarie prodhimin, importin e tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që kërkon të ushtrojë një veprimtari të prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të kategorive të larta, paraqet online në platformën qeveritare “e-Albania” dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomë “Bachelor” ose “Master” të drejtuesit teknik në fushën e agronomisë ose në fushën e inxhinierisë së pyjeve për rastet e materialit mbjellës pyjor;

b) kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit teknik.”.

3. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2 me këtë përmbajtje:

“5/1. Vendimi për miratim apo refuzim të kërkesës për prodhim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të kategorive të larta merret nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV).

5/2. Rregullat, procedura dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

4. Pas pikës 8 shtohen pikat 9 e 10 me këtë përmbajtje:

Faqe| 7494

“9. Operatori profesionist kryen rianalizimin për fuqinë mbirëse për materialin mbjellës shumëzues bimor të vendosur në treg.

10. Rregullat për rianalizimin për fuqinë mbirëse të materialit mbjellës miratohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 8

Në nenin 13, në pikën 4, fjalët “me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohet me fjalët “dhe legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 9

Në nenin 16 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Procedura të tjera për certifikimin zyrtar, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, certifikatës së materialit mbjellës dhe mënyra e njoftimit të drejtuesit të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për pyjet e kullotat.”.

Neni 10

Në nenin 23 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë së importit dhe tregimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor e ka çdo person juridik ose fizik, me objekt veprimtarie prodhimin, importin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që i paraqet institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg, dokumentacionin si më poshtë:

a) diplomë “Bachelor” ose “Master” të drejtuesit teknik në fushën e agronomisë ose në fushën e inxhinierisë së pyjeve për rastet e materialit mbjellës pyjor;

b) kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit teknik.”.

Neni 11

Në nenin 24 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor lidhur me plotësimin e kërkesave



të përcaktuara për tregtim në këtë ligj kryhet në bazë të planit vjetor të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë risku, të miratuar nga ministri.”.

Neni 12

Në nenin 26 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Importi për raste emergjente i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet me autorizim të veçantë të ministrit.”.

Neni 13

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “të cilat i boton në buletin e saj zyrtar” hiqen.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Katalogu Kombëtar publikohet në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve e të ministrisë dhe përditësohet sa herë që pëson ndryshime. Forma dhe përmbajtja e Katalogut Kombëtar miratohen me urdhër të ministrit.”.

Neni 14

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Kërkesa për regjistrimin e një varieteti

1. Kërkesa për regjistrimin e një varieteti kryhet në sistemin online në platformën qeveritare “e-Albania” dhe përmban:

a) dokumentin që vërteton provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS);

b) deklaratën në rastet kur kërkesa bëhet për regjistrimin e një varieteti të një fare bari, që nuk ka destinacion prodhimin foragjer, ose për një varietet të përcaktuar për përdorim vetëm si komponent gjenetik për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve apo i një varieteti, i cili është OMGJ.

2. Të dhënat e kërkuara nga kërkuuesi për origjinën e varietetit trajtohen si të dhëna konfidenciale.”.

Neni 15

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Regjistrimi i varietetit në Katalogun Kombëtar kryhet nëse plotësohen këto kushte:

a) vërtetohet se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, është miratuar si varietet i ri dhe është caktuar personi përgjegjës për ruajtjen e tij;

b) vërtetohet e drejta për përdorimin e këtij varieteti;

c) plotëson standardet e pranueshme për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit, të miratuara me vendim të KRV-së;

ç) deklarohet se varieteti nuk bën pjesë në listën e llojeve të huaja invazive dhe/apo miratimin përkatës nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Një varietet, që është OMGJ, regjistrohet vetëm nëse plotëson kushtet e specifikuar në pikën 1 të këtij neni, dhe nëse pranimi ose mbajtja e një varieteti të tillë nuk bie në kundërshtim me legjislacionin përkatës për OMGJ-të.”.

Neni 16

Në nenin 33, fjalia e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në qoftë se kërkuuesi deklaron në kërkesë se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet e stabilitet dhe është miratuar si varietet i ri në Republikën e Shqipërisë ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose në një nga shtetet nënshkruese të konventës së UPOV-it, testimi mundet të mos kryhet me kusht që operatori profesionist për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkon të testojë, të paraqesë në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dokumentacion zyrtar, nëpërmjet të cilit vërtetohen karakteristikat e materialit mbjellës e shumëzues bimor (skeda) dhe provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet e stabilitet (DUS).”.

Neni 17

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Regjistrimi i varietetit në Katalogun Kombëtar

1. Komisioni i Regjistrimit të Varietetit (KRV), sipas vlerësimit të dërguar nga ESHFF-ja për vlerën e kultivimit dhe përdorimit (VKP) dhe të DUS-it,



vendos për regjistrimin ose jo të varietetit në Katalogun Kombëtar.

2. Kostoja financiare e krijuar për regjistrimin e varietetit përballohet nga operatori profesionist.

3. Procedura dhe afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të një varieteti në Katalogun Kombëtar miratohen me udhëzimin e ministrit.”

Neni 18

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, në shkronjën “c” shkurtesa “KVVVRKK” zëvendësohet me shkurtesën “ESHFF”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vendimi për çregjistrimin merret nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV).”.

Neni 19

Në nenin 39, pika 1, fjala “të listuar” zëvendësohet me fjalën “të regjistruar”.

Neni 20

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)

1. Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV) është organ kolegjal, teknik, i përhershëm dhe vendimmarrës.

2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV) miratohen me urdhër të ministrit.

3. Anëtarët e komisionit caktohen me urdhër të ministrit, me propozimin e institucioneve përkatëse.

4. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e MMSHB-së dhe paraprakisht duhet të deklarojnë marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet e prodhimit apo të tregutit të MMSHB-së.”.

Neni 21

Në nenin 41 në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) të ndjekë procedurat për regjistrimin e varieteteve;”.

2. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) të analizojë mostrat e materialit mbjellës e shumëzues bimor të vendosura në treg, të sjella nga struktura përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, si dhe subjektet private”;

3. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) të publikojë KK-në në faqen zyrtare.”.

Neni 22

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet: “Struktura përgjegjëse për inspektimin e kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë”.

2. Fjala hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Detyrat e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë:”.

3. Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“a) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të operatorit profesionist në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet e tregtohet.”.

4. Në shkronjën “c” të pikës 1 hiqet fjala “të importuar”.

Neni 23

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Veprimtari të ndaluara

1. Ndalohet prodhimi dhe vendosja në treg:

a) e materialit mbjellës e shumëzues bimor të paregjistruar në Katalogun Kombëtar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

b) e materialit mbjellës e shumëzues bimor, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 11 dhe me pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji.

2. Ndalohet përkohësisht tregtimi i materialit mbjellës e shumëzues bimor, i cili nuk është ambalazhuar dhe etiketuar sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.”.



Neni 24

Në nenin 44 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Laboratori i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës e shumëzues bimor, sipas metodikave të Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farërave (ISTA).”.

Neni 25

Në nenin 55 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të drejtën e vendosjes së masës administrative, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, e kanë inspektorët e strukturës përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për inspektimin”.

Neni 26

Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar, zbatohen deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 16, pika 4, 19, pika 5, 35, pika 3, dhe 40, pika 2, të ligjit.

Neni 27

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 2; 11, pikat 5/2 dhe 10; 15, pika 3; 16, pika 4; 17, pika 4; 18, pika 1; 19, pika 5; 24, pika 4; 29, pika 3; 35, pika 3, dhe 40, pika 2, të ligjit.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025

Shpallur me dekretin nr. 103, datë 1.4.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 103, datë 1.4.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 21/2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, ‘Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 22/2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 90/2016, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË
PROGRAMEVE TË ASISTENCËS,
AKREDITUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN, NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Zyrtari Kombëtar i Autorizuar”, “drejtor i Agjencisë” dhe “zëvendës-



drejtor i Agjencisë” zëvendësohen me fjalët “Zyrtari Kombëtar Autorizues”, “drejtor i përgjithshëm i Agjencisë” dhe “zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Agjencisë”.

Neni 2

Në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 5 emërtesa “Bashkimi Evropian” zëvendësohet me emërtesën “Komisioni Evropian”.

Neni 3

Shkronja “c” e pikës 3 të nenit 8 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli Mbikëqyrës monitoron funksionimin e sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm në Agjenci.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë, të cilët emërohen nga Kryeministri për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.”.

Neni 5

Shkronja “a” e nenit 11 shfuqizohet.

Neni 6

Shkronja “c” e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“c) të ketë të paktën 7 vjet përvojë pune në profesion ose të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë në fushën e auditimit.”.

Neni 7

Në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 15 fjalët “si dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të punonjësve në veçanti.” hiqen.

Neni 8

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) shkronjat “a”, “b”, “e” dhe “ë” ndryshohen si më poshtë:

Faqe | 7498

“a) miraton dokumentet strategjike dhe të planifikimit të auditimit;

b) miraton metodologjinë e auditimit dhe ndryshimet e mëtejshme të kësaj metodologjie në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit;

...

e) siguron funksionimin efektiv të sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm në Agjenci;

ë) është përgjegjës për hartimin e raporteve vjetore, sipas marrëveshjes kuadër, dhe lëshon opinionin vjetor të auditimit bazuar në raportin vjetor të aktiviteteve audituese.”.

b) në shkronjën “dh” pas fjalëve “kontrollit të brendshëm” shtohen fjalët “në Agjenci”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Drejtori i përgjithshëm harton një raport vjetor për veprimtarinë dhe drejtimin e Agjencisë brenda muajit prill të çdo viti.”.

Neni 9

Në fjalinë e fundit të pikës 7 të nenit 22 fjalët “pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit Mbikëqyrës” hiqen.

Neni 10

Në nenin 25 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) auditimi i llogarive, që kanë si qëllim plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve ose pasqyrave financiare vjetore dhe llogaritë vjetore të tyre.”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e dytë fjala “pajtueshmërisë” zëvendësohet me fjalën “përputhshmërisë”;

b) Fjala e fundit shfuqizohet.

Neni 11

Hyra në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

Shpallur me dekretin nr. 104, datë 1.4.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



DEKRET
Nr. 104, datë 1.4.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë””.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 11, datë 10.3.2025

PËR EKSPORTIN E PRODUKTEVE DHE
NËNPRODUKTEVE PËRFUNDIMTARE
TË BIMËS SË *CANNABIS*-IT PËR
QËLLIME INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, pika 3 e nenit 32, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,

UDHËZOJMË:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i eksportit të produkteve dhe nënprodukteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale.

Neni 2
Objekti

1. Përcaktimi i kriterëve, dokumentacionit që duhet të plotësojnë dhe procedurat që duhet të

ndjekin subjektet e lejuara për eksportin e nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale;

2. Përcaktimi i procedurave që ndiqen nga Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it (në vijim *Agjencia*) për lëshimin e autorizimit për eksport dhe të dhënat që duhet të përmbajë autorizimi.

3. Përcaktimi i rregullave për shkëmbimin, administrimin e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me eksportin e nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale.

Neni 3
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuara në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” dhe në ligjin nr.102/2014, “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Për efekt të këtij udhëzimi, përkufizimet shtesë kanë këto kuptime:

1. “**Eksporti**” nënkupton dërgimin e nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it nga Shqipëria drejt një vendi tjetër.

2. “**Eksportues**” nënkupton subjektin e pajisur me lejen përkatëse për kryerjen e eksportit të nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it dhe që plotëson kërkesat e vendit pritës sipas parashikimeve ligjore.

3. “**Pritësi**” nënkupton subjektin marrës të nënprodukteve apo produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, në vendin pritës.

4. “**Autorizim i eksportit**” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Agjencia për subjektet e pajisura me leje, që i autorizon të eksportojnë nënproduktet apo produktet e bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale.

5. “**Ngarkesë**” nënkupton një sasi të nënprodukteve apo produkteve të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, të cilat transportohen në një destinacion të caktuar.

6. “**Certifikatë fitosanitare**” është një dokument zyrtar i lëshuar nga agronomi i Autoritetit



Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për një dërgesë që parashikohet të shoqërohet me certifikatë fitosanitare në përputhje me legjislacionin për shëndetin e bimëve.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Subjekti i lejuar zbaton rregulla, standarde dhe procedura të përshtatshme në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, për eksportin e nënprodukteve dhe produkteve të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, në mënyrë që të garantohet përmbushja e kushteve të sigurisë dhe të cilësisë, të parandalohet aksesimi i paautorizuar, si dhe çdo formë tjetërsimi e paligjshme, si dhe respektimi i parashikimeve në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

2. Subjekti i lejuar është përgjegjës për përgatitjen dhe plotësimin e dokumentacionit për eksport, si dhe përmbushjen e kushteve të cilësisë të nënprodukteve dhe produkteve të bimës së *cannabis*-it që do të eksportohen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kërkesat e vendit pritës.

3. Subjekti i lejuar pajiset për çdo ngarkesë me autorizimin përkatës të eksportit.

4. Subjekti i lejuar eksporton nënprodukte dhe produkte të bimës së *cannabis*-it, vetëm për subjekte pritëse të cilat janë të pajisura me certifikatë importi apo dokument tjetër analog me këtë certifikatë të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit të vendit pritës, si dhe dokumentacion përkatës.

5. Agjencia dhe struktura përgjegjëse për doganat bashkëpunojnë për të siguruar realizimin e eksportit të nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale, në kohë dhe në përputhje me procedurat administrative të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 5

Kriteret për pajisjen me autorizim eksporti

1. Eksportuesi, duhet të përmbushë kriteret si vijon:

a) të jetë i pajisur paraprakisht me lejen përkatëse për kryerjen e aktivitetit të eksportit;

b) të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me:

i. shenjimin dhe gjurmimin;

ii. standardet për çdo fazë të procesit të kultivimit;

iii. paketimin dhe etiketimin;

iv. rregullat dhe kushtet e sigurisë së transportit.

2. Eksportuesi plotëson kriteret dhe kushtet e tjera të përcaktuara nga ligji nr. 61/2023 dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij.

Neni 6

Dokumentacioni për pajisjen me autorizim eksporti

1. Subjekti i lejuar, që kërkon të pajiset me autorizim eksporti të nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, paraqet pranë Agjencisë, si dhe hedh në Regjistër kërkesën për autorizim dhe dokumentacionin shoqërues, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë para datës së parashikuar për kryerjen e eksportit.

2. Kërkesa për t'u pajisur me autorizim eksporti përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emërtimi dhe lloji i produktit që eksportohet, varietetin e bimës së *cannabis*-it, qëllimin e përdorimit dhe sasinë për secilën formë;

b) emërtimi, NIPT-i dhe adresa e subjektit të lejuar, si dhe emri i përfaqësuesit ligjor të tij apo të personit të autorizuar për të ndjekur procedurën e lëshimit të autorizimit;

c) emërtimi, NIPT-i dhe adresa e subjektit importues, emri i përfaqësuesit ligjor të tij, si dhe të dhënat e kontaktit (adresa e-mail dhe numri i telefonit);

ç) pika doganore ku parashikohet dalja e ngarkesës nga territori i Republikës Shqipërisë;

d) datën e parashikuar për kryerjen e eksportit;

dh) të dhënat e shenjës unike të identifikimit dhe të gjurmimit për nënproduktet dhe produktet përfundimtare që eksportohen;

e) përqendrimin e THC-së, të shprehur si përqindje, të bimës së thatë, të nënproduktit apo produktit përfundimtar;

ë) pikën doganore ku do të bëhet procedura doganore e eksportit;

f) kodin sipas Nomenklaturës së Mallrave.

3. Dokumentacioni shoqërues që subjekti duhet të paraqesë për pajisjen me autorizim eksporti është si vijon:

a) kopja e certifikatës së analizës së nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi;



b) kopja e kontratës së shërbimit me shoqërinë transportuese, nëse transporti nuk kryhet nga vetë subjekti;

c) kopja e kontratës së shitjes me subjektin e huaj importues, e përkthyer dhe noterizuar;

ç) kopja e certifikatës së importit apo dokument tjetër analog, lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit pritës, për vendet që parashikojnë detyrimin për t'u pajisur me këtë dokument.

Neni 7

Procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për autorizim

1. Agjencia, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për autorizim eksporti me shkrim, merr në shqyrtim kërkesën e subjektit të lejuar dhe verifikon dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

2. Në rastet kur Agjencia gjatë shqyrtimit të kërkesës konstaton mangësi të dokumentacionit, kërkon me shkresë plotësimin e tyre. Subjekti brenda 5 (pesë) ditë pune plotëson mangësitë e konstatuara, i përcjell në Agjenci dhe i hedh në Regjistër, në të kundërt kërkesa konsiderohet e refuzuar. Për këtë subjekti njoftohet me shkresë nga Agjencia, njëkohësisht njoftimi pasqyrohet në Regjistër.

3. Agjencia ka të drejtë të kryejë verifikimet përkatëse të dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i lejuar kur ka indicie apo konstaton mospërputhje në dokumentet e përcjella.

4. Kur dokumentacioni është i plotë dhe subjekti plotëson të gjitha kërkesat, Agjencia, lëshon autorizimin për eksport.

Neni 8

Autorizimi i eksportit

1. Autorizimi i eksportit përmban këto të dhëna:

a) emrin dhe llojin e produktit, sasinë që do të eksportohet;

b) emrin, adresën dhe NIPT-in e eksportuesit, si dhe emrin ndërkombëtar të pronarit (nëse ka);

c) emrin, adresën dhe NIPT-in e subjektit pritës;

ç) datën kur do të kryhet eksporti;

d) nëse vendi pritës parashikon detyrimin për t'u pajisur me certifikatë importi apo dokument tjetër analog me këtë certifikatë, numrin dhe datën e

certifikatës së importit dhe autoritetin që e ka lëshuar atë;

dh) pikën doganore ku do të kryhen procedurat doganore të eksportit;

e) kodin e Nomenklaturës së Mallrave që eksportohen.

2. Autorizimi është i vlefshëm për datën e parashikuar për kryerjen e eksportit. Nëse për arsye të caktuara objektive lind nevoja për ndryshimin e datës së eksportit, subjekti i lejuar njofton Agjencinë për konfirmimin.

3. Autorizimi jepet vetëm në emër të subjektit dhe është i patransferueshëm dhe i patjetërsueshëm.

4. Format i autorizimit për eksport është sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

5. Autorizimi i lëshuar ngarkohet në Regjistër.

Neni 9

Dokumentacioni për procedurat doganore

Subjekti paraqet pranë organeve doganore dokumentacion e mëposhtëm:

a) autorizimin e eksportit të lëshuar nga Agjencia;

b) deklaratën doganore që lëshohet në fillim të kryerjes së procedurës doganore të eksportit;

c) faturën e mallit;

ç) listën e paketimit;

d) certifikatën e analizës;

dh) certifikatën e origjinës/certifikatën e origjinës EUR.1 nëse kërkohet nga vendi pritës,

e) certifikatën fitosanitare;

ë) dokumentin e transportit.

Neni 10

Kryerja e formaliteteve doganore

1. Subjekti i lejuar, pas marrjes së autorizimit për eksport nga Agjencia, aplikon pranë degës doganore ku do të kryejë procedurat doganore, dhe me miratim të kryetarit të degës doganore, kontrollat doganore dhe plumbosja e mallrave të ngarkuar për t'u eksportuar, kryhen në mjediset e njësisë së prodhimit të subjektit të lejuar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 102/2014, "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Në rast se gjatë procedurave doganore që kryhen në pikën kufitare të daljes konstatohet se, subjekti eksporton ngarkesë në sasi të ndryshme nga



ajo e deklaruar dhe e autorizuar, apo gjatë skanimit evidentohet prania e produkteve të tjera jo në përputhje me autorizimin, autoriteti doganor njofton menjëherë në numrin dhe adresën elektronike të kontaktit të vendosur në dispozicion nga palët paraprakisht, Policinë e Shtetit, Agjencinë dhe eksportuesin për faktet e konstatuara dhe vendimmarrjet. Autoriteti doganor vendos kryerjen e kontrollit fizik të ngarkesës në ambientet e pikës doganore duke siguruar kushtet e ruajtjes së produktit që eksportohet.

3. Nëse pas verifikimit të kryer sipas pikës 2 të këtij neni, rezulton se ngarkesa është në përputhje me të dhënat e deklaruar dhe autorizimin, atëherë autoriteti doganor vijon me procedurën e parashikuar në ligj për eksportin e mallrave.

4. Nëse sasia është e ndryshme me atë të deklaruar dhe autorizuar, Agjencia pas kryerjes së kontrollit fizik dhe njoftimit me shkrim nga autoriteti doganor merr masë administrative për subjektin e lejuar sipas dispozitave të ligjit nr. 61/2023. Në vijim subjekti kërkon pranë Agjencisë korrigjimin e sasisë së deklaruar në autorizim dhe Agjencia brenda 5 ditëve lëshon autorizimin. Po kështu dhe autoritetet doganore kryejnë korrigjimin e deklaratës doganore dhe vijohet me procedurat përkatëse të eksportit.

5. Nëse pas verifikimit të kryer sipas pikës 2 të këtij neni, rezulton se ngarkesa nuk mund të eksportohet njofton me shkrim mbi arsyet përkatëse Policinë e Shtetit, Agjencinë dhe Subjektin. Subjekti është i detyruar që të kthejë ngarkesën në ambientet e njësisë së prodhimit, duke garantuar dhe respektuar të gjitha kushtet për transportin dhe sigurinë sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat dhe tarifat për ruajtjen dhe sigurinë fizike për subjektet e lejuara. Ngarkesa vulolet nga autoritetet doganore në pikën doganore ku po kryhen procedurat dhe vula do të hiqet në ambientet e njësisë së prodhimit të subjektit të lejuar në prezencë të punonjësit të Agjencisë. Kur vendimmarrja për këtë kthim nga autoritetet doganor është në përputhje me gjetjet e konstatuara nga kontrolli fizik, shpenzimet e transportit dhe të ruajtjes dhe sigurisë janë në ngarkim të subjektit të lejuar.

6. Nëse produkti është i paligjshëm dhe konfiskohet apo sekuestrohet nga Policia e Shtetit njoftohet me shkrim dhe Agjencia.

7. Agjencia, me marrjen e njoftimit sipas pikës 5 dhe 6 të këtij neni, shfuqizon autorizimin.

8. Të gjitha aktet administrative dhe njoftimet të përmendura në këtë nen, hidhen në Regjistër.

Neni 11

Bashkëpunimi me autoritetet doganore

1. Agjencia bashkëpunon me autoritetet doganore në vend, duke shkëmbyer zyrtarisht informacion për subjektin e lejuar që është pajisur me autorizim për eksport dhe kryen procedura eksporti, si dhe për përgatitjen e manualeve teknike specifike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore aksesojnë, përmes Regjistrit, të dhënat e eksporteve nga subjekti i lejuar.

Neni 12

Dispozitat e fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, Policia e Shtetit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoritetet Doganore, institucionet e tjera që zbatojnë përcaktime nga ky udhëzim dhe subjektet e lejuara.

2. Udhëzimi nr. 15, datë 21.5.2024, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, “Për rregullat e eksportit të produkteve dhe nënprodukteve përfundimtare të *cannabis*-it për qëllime industriale”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja



ANEKSI NR. 1

AGJENCIA KOMBËTARE E KONTROLLIT TË *CANNABIS*-it

AUTORIZIM

NR. _____, DATË _____

PËR EKSPORTIN E PRODUKTEVE DHE NËNPRODUKTEVE TË *CANNABIS*-it
PËR QËLLIME INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”,

I JEPET:

SUBJEKTTI
EKSPORTUES: _____
ADRESA E SUBJEKTTI
EKSPORTUES: _____
NUIS/ NIPT-i I SUBJEKTTI
EKSPORTUES: _____
EMRI NDËRKOMBËTAR I PRONARIT: _____
DATA E KRYERJES SË EKSPORTIT: _____
PIKA DOGANORE: _____
KODI I NOMENKLATURËS SË
MALLRAVE: _____

PËR

PRODUKTIN: _____
E LLOJIT: _____
ME SASINË: _____

I CILI EKSPORTOHET DREJT

DESTINACIONIT (shteti pritës): _____
SUBJEKTTI
PRITËS: _____
ADRESA E SUBJEKTTI
PRITËS: _____
NUIS/ NIPT-i I SUBJEKTTI
PRITËS: _____
NUMRI I CERTIFIKATËS/DOKUMENTIT TË IMPORTIT*: _____
DATA E CERTIFIKATËS/DOKUMENTIT TË IMPORTIT*: _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
(EMËR, MBIEMËR)
(FIRMË)

* Plotësohet nëse vendi pritës parashikon detyrimin për t’u pajisur me certifikatë importi apo dokument tjetër analog.



URDHËR

Nr. 304, datë 28.3.2025

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENIN E OHRIT DHE
GRUMBULLIMIN E RIPRODHUESVE
TË KRAPIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit (me përjashtim të koranit), konkretisht:

a) për gjuhcën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2025;

b) për krapin – *Cyprinus Carpio*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2025.

2. Për periudhën 20.7.2025 deri më 20.8.2025, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP Pogradec.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së riprodhuesve të krapit (*Cyprinus Carpio*).

5. Për periudhën prej 20.4.2025 deri më 20.7.2025, të lejohet peshkimi i riprodhuesve të krapit në përputhje me kapacitetet mbajtëse të Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Veprimtaria e grumbullimit të riprodhuesve të organizohet dhe të kryhet nën drejtimin e DSHPA-së në bashkëpunim me OMP Pogradec, duke përcaktuar dhe aktivizuar për këtë qëllim jo më shumë se 20 peshkatarë me përvojë, anëtarë të kësaj OMP-je.

7. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP Pogradec.

8. OMP Pogradec të marrë të gjitha masat për zhvendosjen e objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët në mënyrë natyrale, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqen.

9. OMP Pogradec bashkëpunon me strukturat vendore Pogradec, Komisaratin e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve në fshatin Lin të Pogradecit, si dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 305, datë 28.3.2025

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENIN E SHKODRËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të krapit – (*Cyprinus carpio*) në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2025 deri më 30.4.2025.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të gjuhcës (cironkës) – *Alburnus Albidus Alborella* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2025 deri më 31.7.2025.

3. Për periudhën 1.4.2025 deri më 30.4.2025 lejohet të peshkohet vetëm ngjala me grepa nga subjektet e pajisura me leje peshkimi nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjalës.

4. Për periudhën 1.5.2025 deri më 30.6.2025, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 m nga bregu.



5. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë sipas zonave të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

6. Për periudhën e lejimit të peshkimit të ngjalës, sipas pikës 3 të këtij urdhri, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara.

7. Peshku i sekuestruar nga peshkimi i paligjshëm gropset.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

9. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

10. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, bashkëpunon me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Shkodër, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës dhe Policinë Bashkiake të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

11. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 306, datë 28.3.2025

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENET E PRESPËS, FIERZËS, ULZËS
DHE SHKOPETIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitim

në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, konkretisht:

a) për gjuhçën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2025;

b) për krapin – *Cyprinus Carpio*, prej 25 prillit deri më 25 maj 2025.

2. Për periudhën 25.4.2025 deri më 25.6.2025, ndalohet peshkimi me rrjeta në fashën bregliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitete peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. OMP-të, bashkëpunojnë me strukturat e vetëqeverisjes vendore, Drejtoritë Rajonale të AKU-së, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe me Policitë Bashkiake përkatëse.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

